

Legjionaret/ Bazeli gati te rrembeje Amir Abrashin

nga AlbaniaSoccer

E martë, 26 Nentor 2013 20:08



Bazel kerkon te marre futbollistin shqiptar Amir Abrashi. Lajmi eshte bere i ditur nga mediat zviceriane te cilat e shohin si nje mundesi te arte kete levizje per mesfushorin e kombetares kuqezi. Abrashi po shkelqen te Grasshoppers dhe kohet e fundit ka rene ne syte edhe te menaxhereve te Lacios, te cilet kane shprehur interesin e tyre. Megjithate, per momentin nuk mund te flitet me siguri per te ardhmen e mesfushorit 23-vjeçar, pasi eshte nen kontrate me ekipin ku aktivizohet prej tre sezonesh deri ne fund te 2014-es. Grasshoppers kerkon nje shume te majme per ta lene te lire ndaj dhe transferimi i tij tek Bazeli nuk eshte i thjeshte per tu realizuar.